

Talat Xhaferi pranon
mandatin për formimin
e qeverisë teknike



FAQE 6

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

STOLTENBERGU: SITUATA NË BALLKAN E BRISHTË, ME POTENCIAL PËR TENSIONE NË KOSOVË DHE BOSNJË

FAQE 4-5



Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, ka theksuar se NATO-ja beson se situata e sigurisë në Ballkanin Perëndimor është ende shumë e brishtë dhe ka potencial

për tensione në Kosovë dhe Bosnjë-Hercegovinë. "Situata në rajonin e Ballkanit Perëndimor mbetet e brishtë. Dhuna që ka shpërthyer në Kosovë ishte e papranueshme. Kjo

ka bërë që NATO-ja menjëherë të angazhojë forca shtesë në Kosovë", ka thënë Stoltenbergu të premten pas takimit me kryeministrin e Malit të Zi, Milo Đukanović.

KURTI: PROCESI I INTEGRIMIT NË BE TË JETË I NDARË NGA AI I NORMALIZIMIT TË MARRËDHËNIEVE ME SERBINË

F. 3



KRIZA NË DETIN E KUQ PRITET T'I RRIJË DISA ÇMIME NË KOSOVË

F. 5

AKTUALE



GJND-ja NUK URDHËRON ARMËPUSHIM NË GAZË, I KËRKON IZRAELIT T'I PARANDALOHË VRASJET DHE DËMET

F. 2

KUSH DO ZGJEDHJE TË PARAKOHSHME?

F. 4

FAZA E TRETË E PROGRAMIT "ARTI NË SHKOLLA" PRITET TË REALIZOHET NË 15 KOMUNA

F. 6

EKONOMI



NË VERI TË KOSOVËS JANË REGJISTRUAR 374 BIZNESE, RRETH 280 KANË PAGUAR TATIME

F. 8

KOSOVA DHE BULLGARIA NËNSHKRUAJNË MARRËVESHJE NË FUSHËN E BUJQËSISË DHE TË ZHVILLIMIT RURAL

F. 8

SPORT



LANSOHET PROGRAMI "SPORT NË SHKOLLA", KURTI: TË NDËRTOHET NJË SHOQËRI E SHËNDETSHME

F. 10

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Buniamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

GjND-ja nuk urdhëron armëpushim në Gazë, i kërkon Izraelit t'i parandalojë vdekjet dhe dëmet

HAGË, 26 JANAR - Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë nuk ka urdhëruar të premten armëpushim në Gazë, por i ka kërkuar Izraelit t'i marrë të gjitha masat për të parandaluar akte të gjenocidit.

Gjykata ka thënë se ka juridiksion për të vendosur për masa urgjente, të kërkuara nga Afrika e Jugut, në rastin kundër Izraelit, në luftën e tij kundër Hamasit në Gazë. Hamas, grup palestinez që udhëheq Rripin e Gazës, është shpallur organizatë terroriste prej Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Evropian.

Gjykata nuk ka marrë vendim në kërkesën e Afrikës së Jugut nëse ka ndodhur gjenocid në Gazë. Megjithatë, e ka njohur të drejtën e palestinezëve në Gazë që të mbrohen prej akteve të gjenocidit.

Afrika e Jugut e ka konsideruar vendimin e GjND-së, për ta trajtuar rastin e hartuar nga ajo, si "fitore vendimtare" për rendin dhe ligjin ndërkombëtar. "Afrika e Jugut shpreson, sinjerisht, që

Izraeli nuk do të veprojë për ta penguar aplikimin e këtij urdhri, siç ka kërcënuar publikisht, mirëpo do ta zbatojë atë plotësisht, sikurse i kërkohet".

Çfarë tha tjetër GjND-ja?

Gjykata ka thënë se Izraeli duhet të marrë masa për ta përmirësuar situatën humanitare në Gazë.

Sipas saj, Izraeli duhet t'i raportojë gjykatës brenda një muaji, për të treguar se çfarë po bën për ta zbatuar urdhrin.

Izraeli i ka konsideruar akuzat ndaj tij si të "pabaza".

Ndalja e luftimeve në Gazë ka qenë kërkesa kryesore e Afrikës së Jugut.

Si pasojë e operacionit ushtarak të Izraelit në Gazë, janë vrarë më shumë se 25 000 palestinezë, sipas autoriteteve shëndetësore palestineze.

Kryetarja e trupit gjykues, Joan Donoghue, ka thënë se gjykata është "thelësisht e shqetësuar" nga vazhdimi i humbjes së jetëve dhe vuajtjeve të njerëzve.



Izraeli i ka shpallur luftë Hamasit më 7 tetor 2023, pak pasi grupi ka kryer sulme vdekjeprurëse në tokën e tij, duke i lënë rreth 1 200 njerëz të vrarë dhe duke marrë mbi 240 pengje.

Disa janë liruuar ndërkohë.

Kombet e Bashkuara dhe agjenci

ndërkombëtare për ndihmë vlerësojnë se luftimet kanë shkakuar katastrofë humanitare në Gazë, pasi një çerek i këtij territori, me 2.3 milionë banorë, po përballet me uri. Johaneshburgu beson se Izraeli është duke vepruar në

kundërshtim me Konventën e OKB-së për Gjenocid, të vitit 1948, e cila është hartuar pas Luftë së Dytë Botërore dhe Holokaustit.

Afrika e Jugut dhe Izraeli janë pjesë e Konventës së OKB-së për Gjenocid.

ShBA-ja dhe Britania sanksionojnë zyrtarë të lartë të Huthëve pas sulmeve në Detin e Kuq

UASHINGTON, 26 JANAR - Shtetet e Bashkuara dhe Britania kanë bërë me dije se kanë vendosur sanksione të koordinuara ndaj katër figurave të rebelëve Huthi për rolin e tyre në mbështetjen dhe organizimin e sulmeve ndaj anijeve komerciale në Detin e Kuq.

Sulmet e Huthëve, të përkrahura prej Iranit, kanë çrregulluar tregtinë globale dhe kanë rritur shqetësimet për rritje të inflacionit. Këto veprime i kanë thelluar shqetësimet se pasojat e luftës Izrael-Hamas mund ta destabilizojnë Lindjen e Mesme. Në mesin e personave të sanksionuar janë ministri i Mbrojtjes i Huthëve, Mohamed



Nasser al-Atifi, komandanti i forcave detare të Huthëve, Muhammad Fadl Abd Al-Nabi, shefi i forcave të mbrojtjes

detare, Muhammad Ali al-Qadiri dhe Muhammed Ahmad al-Talibi, të cilin të dyja qeveritë e kanë përshkruar si drejtor të

prokurimit për rebelët Huthi. "Bashkë me aleatët tanë ne do të vazhdojmë t'i shënjestrojmë personat përgjegjës për veprimet e papranueshme dhe joligjore të Huthëve, të cilat rrezikojnë jetën e detarëve të pafajshëm dhe pengojnë bartjen e ndihmave për banorët e Jemenit", ka thënë sekretari i jashtëm britanik, David Cameron, i cili është në vizitë në Lindje të Mesme. Sanksionet synojnë t'u pamundësojnë Huthëve të kryejnë sulme në Detin e Kuq, ka thënë Britania.

Thesari amerikan ka thënë se al-Atifi ka paralajmëruar publikisht se Huthët do ta shndërrojnë Detin e Kuq në varrezë, në

përgjigje të sulmeve të koalicionit të udhëhequr nga ShBA-ja kundër Jemenit, me qëllim të sigurimit të trafikut komercial.

Al-Talibi është i përfshirë në përpjekjet për të kontrabanduar armë të ofruara prej Iranit, raketa, dronë në Jemen, ka thënë ShBA-ja.

Me këto sanksione, ShBA-ja ngrin të gjitha asetet që kanë personat e shënjestruar në tokën amerikane, dhe ua ndalon amerikanëve të kenë kontakte me ta.

Britania ka thënë se personave të sanksionuar do t'u ngrihen asetet, do t'u vendosen embargo për armët dhe do t'u ndalohen udhëtimet drejt saj.

Trumpi mohon në gjykatë se e ka abuzuar seksualisht shkrimtaren Carroll

UASHINGTON, 26 JANAR - Dëshmia e ish-presidentit amerikan Donald Trump, në rastin e nisur kundër tij, prej shkrimtares E. Jean Carroll, ka përfunduar gati menjëherë pasi ka nisur. Ai e ka përsëritur deklaratën e tij paraprake, që pretendimi i shkrimtares se Trump e ka dhunuar është vetëm një mashtrim. "Njëqind për qind po", i ka thënë Trump avokates së tij, Alina Habba, në gjykatën federale në Manhatan, kur është pyetur nëse komentet e tij në tetor të

vitit 2022, për këtë rast, kanë qenë të sakta.

Më herët gjatë së enjtes, avokatët e Carrollit e kanë publikuar një incizim të seancave të kaluara, në të cilat Trumpi e ka quajtur ish-kolumnisten e revistës "Elle", si "të sëmurë mendërisht", dhe ka kërcënuar se do ta padisë atë. "Është akuzë e rreme. Nuk ka ndodhur kurrë. Nuk do të ndodhte kurrë", ka thënë Trumpi gjatë dëshmisë. Carroll, 80-vjeçare, synon të fitojë një dëmshpërblim prej të paktën 10 milionë dollarëve

lidhur me mohimet e Trumpit, më 2019, se e ka dhunuar atë në mesin e viteve '90 në zhveshtoren e një dyqani në Manhatan.

Në majin e vitit të kaluar një tjetër juri e ka urdhëruar Trumpin ta paguajë Carrollin, 5 milionë dollarë, pasi ai e ka mohuar pretendimin për dhunim.

Trumpi i ka kaluar vetëm katër minuta në seancë.

Gjyqi ka zgjatur katër ditë dhe argumentet përmbyllëse pritët të bëhen publike të premten.



Stoltenbergu: Situata në Ballkan e brishtë, me potencial për tensione në Kosovë dhe Bosnjë

Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, ka theksuar se NATO-ja beson se situata e sigurisë në Ballkanin Perëndimor është ende shumë e brishtë dhe ka potencial për tensione në Kosovë dhe Bosnjë-Hercegovinë. “Situata në rajonin e Ballkanit Perëndimor mbetet e brishtë. Dhuna që ka shpërthyer në Kosovë ishte e papranueshme. Kjo ka bërë që NATO-ja menjëherë të angazhojë forca shtesë në Kosovë”, ka thënë Stoltenbergu të premten pas takimit me kryeministrin e Malit të Zi, Millojko Spajiq

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

Prishtinë, 26 janar - NATO-ja beson se situata e sigurisë në Ballkanin Perëndimor është ende shumë e brishtë dhe ka potencial për tensione në Kosovë dhe Bosnjë-Hercegovinë. Kështu ka thënë të premten prej Brukselit, sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, duke folur pas takimit me kryeministrin e Malit të Zi, Millojko Spajiq. Ai ka thënë se NATO-ja është e gatshme ta kryejë mandatin e saj në Kosovë për të garantuar stabilitet, ashtu sikurse në Bosnjë-Hercegovinë. Ballkani Perëndimor, forcimi i NATO-s, dhe përgatitjet për samitin e Uashingtonit, kanë qenë temat kryesore të këtij takimi. “Situata në rajonin e Ballkanit Perëndimor mbetet e brishtë. Dhuna që ka shpërthyer në Kosovë ishte e papranueshme. Kjo ka bërë që NATO-ja menjëherë të angazhojë forca shtesë në Kosovë”, ka thënë Stoltenberg. Ai ka paralajmëruar se javën që

vjen Këshilli i Atlantikut të Veriut, trupi më i lartë politik i aleancës, do ta vizitojë Bosnjë-Hercegovinën për të dëshmuar në këtë mënyrë edhe mbështetjen e rezervave për integritetin territorial dhe sovranitetin e Bosnjë-Hercegovinës. Stoltenbergu e ka falënderuar Malin e Zi për kontributin në misionin e NATO-s në Kosovë, KFOR, por edhe për rolin konstruktiv për paqe dhe stabilitet në rajonin e Ballkanit. Kryeministri i Malit të Zi, Spajiq, ka thënë se për vendin e tij, stabiliteti në Kosovë ka rëndësi të veçantë dhe, në rast nevojë, Mali i Zi është i gatshëm të rrisë praninë e ushtarëve të saj në misionin e KFOR-it. Spajiq ka thënë se Mali i Zi mbetet anëtar besnik i aleancës së NATO-s dhe i përkushtuar për të avancuar në procesin e integritetit në BE. Ai ka thënë se për vitin 2024, Mali i Zi ka ndarë më shumë se 2 për qind të Bruto Prodhimit Vendor për mbrojtje, që është në përputhje me kërkesat e



NATO-s ndaj të gjitha vendeve anëtare. Shefi i aleancës ka thënë se NATO-ja ka bashkëpunim të ngushtë me BE-në kur janë në pyetje vendet e Ballkanit Perëndimor. Ai e ka nënvizuar sidomos rëndësinë e mbështetjes së dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë për normalizimin e raporteve, që

zhvillohet nën ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian. Pas sulmeve të armatosura kundër Policisë së Kosovës në Banjskë të Zveçanit, në shtator të vitit të kaluar - ku është vrarë rreshteri Afrim Bunjaku - NATO-ja e ka përforcuar misionin e vet KFOR në Kosovë. Tani ka 4 500 pjesëtarë. Kosova e ka fajësuar shtetin e

Serbisë për sulmin, ndonëse kjo e fundit ka mohuar gjithçka. Përgjegjësinë për sulmin e ka marrë Millan Radoičiq, ish-nënkryetar i Listës Serbe, partisë më të madhe të serbëve në Kosovë. E Agjencia Ndërkombëtare e Policisë (INTERPOL) ka lëshuar fletarrestim për të.

Kurti: Procesi i integrimit në BE të jetë i ndarë nga ai i normalizimit të marrëdhënieve me Serbinë

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

Prishtinë, 26 janar - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë të premten se marrëdhënia në mes të Kosovës dhe Serbisë më shumë varet nga Serbia, por kjo nuk duhet të ndikojë te procesi i integrimit në Bashkimin Evropian. Kurti ka theksuar se në krahësim me Serbinë, Kosova është kampione në të gjitha aspektet. Ai ka shtuar se Bashkimi Evropian kërkon fqinjësi të mirë, por ajo mungon dhe se përgjegjësia është te Beogradi zyrtar. “Kosova ka interes jetik që procesi i normalizimit të marrëdhënieve me Serbinë, që pakrahasimisht më shumë varet nga Serbia sesa nga Kosova, të jetë i ndarë prej procesit të integritetit të Bashkimit Evropian. Dhe sa i përket sundimit të ligjit, luftimit të korrupsionit, lirisë së medie, të drejtave të njeriut, cilësisë së zgjedhjeve, Serbia është e pakrahasueshme me Kosovën. Kosova është kampione e Ballkanit. Po ashtu, për rritje



ekonomike dhe rishpërndarje sociale, ne jemi në ngritje e sipër. Janë dyfishuar eksportet, investimet e huaja, janë rritur të hyrat tatimore për 2/3, andaj tash gjithë ky progres ekonomik dhe demokratik i Kosovës të ngelet peng nga Serbia, që orkestron dhe financon paramilitarë, që synojnë

destabilizimin e Kosovës, siç e pamë në fund të shtatorit të vitit të kaluar, nuk është e drejtë. Unë e kuptoj që Bashkimi Evropian e dëshiron fqinjësinë e mirë dhe ne jemi për fqinjësi të mirë, por ajo nënkupton edhe njohje të ndërsjellët de fakto. E kuptojmë rëndësinë e fqinjësisë së mirë, por

kur mungon fqinjësia, duhet të konstatohet përgjegjësi për këtë gjë, dhe nuk është te Prishtina zyrtare, por tek Beogradi zyrtar”, është shprehur Kurti. Kryeministri ka komentuar edhe organizimin e peticioneve për shkarkimin e kryetarëve të komunave në veri. Ai ka thënë se

procesi i zgjedhjeve të parakohshme në katër komunat në veri të Kosovës tashmë ndodhet në rrugën e vet ligjore. “Atje po bëhen peticione me mbledhje të nënshkrimeve. Së pari duhet të mblidhen 20 %, pastaj mbahen votimet. Me 50 % plus një shkaktohen zgjedhjet e reja dhe ndryshohen kryetarët. Unë jam i vetëdijshëm që në zgjedhjet para një viti në katër komunat në veri dalja ka qenë e ulët por, përveç këtyre katër kryetarëve që i kemi atje, dikush tjetër nuk ka legjitimitet. Për legjitimitet më të madh nevojiten zgjedhje të reja. Për zgjedhje të reja duhet të ketë respektim të procedurave ligjore. Masat të cilat dëshirojnë me dhunë të destabilizojnë nuk mund t'i udhëheqin as komunat, as organet shtetërore. Mirëpres qytetarët në veri të Kosovës, kryeministër i të cilëve jam unë, sepse nuk jam kryeministër vetëm i shqiptarëve, që tashmë po i ndjekin procedurat ligjore, në mënyrë që vullneti i tyre për kryetarë të tjerë ta marrë rrugën e drejtë”, ka deklaruar Kurti.



KUSH DO ZGJEDHJE TË PARAKOHSHME?

Analistët: Çështja e Asociacionit do ta shtyjë Qeverinë e Kosovës drejt zgjedhjeve të parakohshme

PRISHTINË, 26 JANAR - Gati çdokush flet për mundësinë e zgjedhjeve të parakohshme në Kosovë - madje edhe prej partisë në pushtet - por, zyrtarisht, askush nuk e thotë se përse vendi do të duhej të shkonte në një proces të ri zgjedhjesh pak muaj para përfundimit të mandatit të qeverisë.

Me këtë pyetje Radio Evropa e Lirë iu drejtua qeverisë së udhëhequr nga Albin Kurti, por nuk mori përgjigje.

Anëtarë të partisë së Kurtit, Lëvizjes Vetëvendosje, kanë thënë në disa raste se “është mirë që të shkohet në zgjedhje të parakohshme”. “Nëse qeveria mendon se duhet ta çojë deri në fund mandatin, kush jam unë që t'i përzihem asaj?”, ka thënë kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, në një intervistë për Televizionin Klan Kosova në fund të muajit të kaluar. Megjithatë, sipas tij, “është mirë që të shkohet në zgjedhje të parakohshme” në mënyrë që “legjitimiteti i pushtetit të ri të përballlet me sfida, e jo sfidat ta orientojnë karakterin e legjitimitetit”.

Konjufca i ka lidhur zgjedhjet me zhvillimet që pritet të ndodhin në Kosovë në vitin 2024, por nuk ka specifikuar

më shumë.

Në favor të zgjedhjeve të parakohshme, ai është shprehur edhe përmes një deklarate dhënë medie në Kosovë javën e kaluar. E nëse zgjedhjet mbahen me rregull, ato do të duhej të zhvilloheshin në shkurt të vitit 2025.

Çfarë mund të pritët në Kosovë?

Kosova që disa muaj është nën trysinë e bashkësisë ndërkombëtare për ta formuar Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe. Në këmbim, ndërkombëtarët i kërkojnë Serbisë ta njohë de facto Kosovën. Të dyja këto çështje janë pjesë e asaj që njihet si Marrëveshja e Ohrit për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë - Serbi. Derisa presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, këmbëngul se Serbia nuk do ta njohë Kosovën, Kurti kërkon që Marrëveshja e Ohrit të zbatohet në tërësi.

Disa analistë thonë se është pikërisht çështja e Asociacionit që do ta shtyjë Qeverinë e Kosovës drejt zgjedhjeve të parakohshme.

Pacolli: Nuk është diskutuar

Fitore Pacolli, deputete e Lëvizjes Vetëvendosje, thotë se brenda partisë për opsionin e zgjedhjeve të parakohshme nuk është folur, por nuk e përjashton mundësinë të diskutohet në ditët në vazhdim. “Ndoshta do të ketë [diskutime] në ditët në vijim por, tani për tani, nuk ka ndonjë diskutim që është zhvilluar brenda Kryesisë [së Lëvizjes Vetëvendosje] për zgjedhje të parakohshme”, thotë Pacolli, vetë anëtare e kësaj kryesie.

Çfarëa thotë opozita?

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, thotë se Kosova ka nevojë për zgjedhje të parakohshme. Këtë qëndrim PDK-ja e ka bërë të qartë qysh në korrik të vitit të kaluar, sipas tij. “Tashmë është e evidente se kjo qeveri në këto tre vjet të qeverisjes së saj i ka sjellë vetëm dëme dhe regres vendit tonë dhe ka dëshmuar paaftësi totale në secilën fushë”, thotë Krasniqi, pa specifikuar më shumë.

Duke folur për Radion Evropa e Lirë, ai shfaq shpresën që partitë politike “të pajtohen sa më parë për datën e zgjedhjeve të parakohshme”.

Nënkryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lutfi Haziri, thotë se partia e tij është e gatshme për zgjedhje të parakohshme, por se nuk do t'i kërkojë ato. Sipas tij, zgjedhjet duhet të jenë të rregullta, sepse pushtetit aktual nuk i ka mbetur edhe shumë kohë deri në fund të mandatit. Megjithatë, shton se zgjedhjet e parakohshme mund t'i provokojë vetë qeveria e kryeministrit Kurti, e cila “përballet me obligimet” që dalin nga dialogu për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë, posaçërisht me procesin që lidhet me formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. “Edhe nëse vendi shkon në zgjedhje [të parakohshme], zoti Kurti do t'i mbajë obligimet mbi shpatulla, politikisht, dhe nuk mund të largohet”, thotë Haziri.

Opsionin e zgjedhjeve të parakohshme e lidh me Asociacionin edhe nënkryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Pal Lekaj. “Unë pres

zgjedhje... Por, mendoj se vetëm presioni ndërkombëtar për zbatim të Asociacionit do të bëjë që Qeveria të shkojë në zgjedhje”, thotë ai.

Partia e tij edhe më herët është shprehur në favor të mbajtjes së zgjedhjeve të parakohshme. Javën e kaluar ajo ka zyrtarizuar një marrëveshje për koalicion parazgjedhor me partinë Nisma.

Çfarë thonë analistët?

Arton Demhasaj nga organizata joqeveritare “Çohu” në Prishtinë thotë se partitë opozitare nuk kanë fuqi numerike për ta iniciuar shkarkimin e qeverisë, rrjedhimisht as zgjedhje të parakohshme. Ai thotë se për zgjedhjet e parakohshme, shkaktare mund të jetë Qeveria e Kosovës, e cila përballet me presion ndërkombëtar për veprime konkrete lidhur me Asociacionin. “Këto veprime unë nuk besoj se Qeveria do t'i bënte në vitin e fundit të mandatit të saj, sepse kjo do të ishte një goditje e rëndë politike për veten e saj... Prandaj, mendoj se partia në pushtet, Vetëvendosja, me shumë gjasa po kërkon zgjedhje para se të arrihet te ky

Bislimi kërkon nga BE-ja që sa më shpejt t'i tërheqë masat represive ndaj Kosovës



PRISHTINË, 26 JANAR - Zëvendëskryeministri i parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog i Kosovës, Besnik Bislimi, ka raportuar të premtën në Komisionin për Integrim Evropian, me ftesë nga ky komision. Në fjalën hyrëse të tij, ai theksoi proceset e ndërmarra në kuadër të integritimit evropian dhe rezultatet e arritura. Nga hyrja në fuqi e liberalizimit të vizave, tek Plani i Rritjes, ku

Kosova përfiton rreth 950 milionë euro brenda katër viteve, e ku të hënën, më 22 janar, ka dorëzuar në BE listën e reformave. “Plani i Rritjes nuk është vetëm një mundësi për reforma dhe rritje ekonomike, por edhe një shans për bashkëpunim dhe integrim më të ngushtë rajonal mes vendeve të Ballkanit Perëndimor. Në këtë kontekst është shumë e rëndësishme që BE-ja sa më

shpejt t'i tërheqë masat represive ndaj Kosovës, meqë Kosova ka përmbushur kërkesat bazë që kanë dalë para vendosjes së masave dhe kemi një situatë të qetë dhe përmes heqjes së masave atëherë i gjithë fokusi kthehet në avancimin e integritimit evropian të Kosovës”, ka thënë zëvendëskryeministri Bislimi. Ai ka theksuar se masat e vendosura nga BE-ja kanë qenë të padrejta. “Masat janë

vendosur në fund të majit nga Komisioni Evropian dhe janë rezultat i eskalimit që ka ndodhur në veri të Kosovës më 29 maj të vitit të kaluar kur protestuesit serbë kanë sulmuar KFOR-in, gazetarët dhe qytetarët tanë”, është shprehur Bislimi. Ai shtoi se prioritar për institucionet e vendit është pranimi i pyetësorit nga Komisioni Evropian në mënyrë që të dëshmohej se

Kosova e meriton statusin e vendit kandidat dhe të vazhdohet tutje me hapa konkretë drejt anëtarësimit. “Ne besojmë se nuk ka asnjë problem teknik që Kosovës t'i adresohet pyetësori në mënyrë që kapacitetet institucionale, ligjore e administrative të vlerësohen nga ana e Komisionit. Institucionet tona e sidomos strukturat tona koordinuese të integritimit evropian janë të gatshme t'i përgjigjen këtij pyetësori, rezultatet e të cilit jemi të bindur se do të na sjellin statusin e vendit kandidat” u shpreh zëvendëskryeministri. Ai paraqiti të arriturat e zbatimit të Planit të Veprimit të Agjendës për Reforma Evropiane deri në fund të vitit 2023 si dhe të arriturat e planifikuara në Programin Kombëtar për Integrim Evropian gjatë vitit që lamë pas. Sipas gjetjeve të raportit përfundimtar, deri në fund të vitit të kaluar janë zbatuar 71.26 % apo 243 nga gjithsej 341 tregues, ndërsa sa i përket Programit Kombëtar për Integrim Evropian, në vitin që lamë pas janë zbatuar 160 nga 242 masa afatshkurtra apo 66.12 %. Më tej, zëvendëskryeministri u përgjigj në të gjitha pyetjet e deputetëve në mbledhje.

Më 27-28 janar trajtohet tema “Luftimi i dezinformimit në Kosovë”

PRISHTINË, 26 JANAR - Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal, nën drejtimin e kryetarit Valon Ramadani, ka pritur të premtën në takim përfaqësues të Parlamentit Evropian lidhur me iniciativën “Kuvendi i Qytetarëve”. Gjatë këtij aktiviteti, i cili do të realizohet më 27-28 janar, pritet të trajtohet tema “Luftimi i dezinformimit në Kosovë”. Kryetari Valon Ramadani falënderoi përfaqësuesit e PE-së për angazhimin e tyre në këtë proces, duke shprehur mbështetjen ndaj kësaj

iniciative. Nga ana e përfaqësuesve të Parlamentit Evropian, Adriana Buchiu, Francesco Ronchi, si dhe ekspertit të jashtëm, Jonathan Moskovic, u potencua nevoja e zhvillimit të kësaj nisme, që njëkohësisht është e para e këtij formati për qytetarët e Kosovës nëpërmjet bashkëpunimit që përfshin Kuvendin e Kosovës, Parlamentin Evropian, Partneritetin Evropian për Demokraci dhe organizatat e shoqërisë civile si Iniciativa e Re Sociale dhe Grupi për Studime Juridike dhe Politike. Sipas tyre, pjesëmarrësit, të cilët janë zgjedhur në mënyrë

të rastësishme, do të kenë mundësi të diskutojnë për strategjitë për luftimin e dezinformimit në Kosovë, me ekspertë nga Kosova, Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara, duke përfshirë ekspertë nga ‘Meta’. Kësisoj, duke rritur dhe forcuar pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin legjislativ, pritet që rekomandimet që vijnë nga “Kuvendi i Qytetarëve” të shqyrtohen më vonë nga Kuvendi i Kosovës. Iniciativa në fjalë u mirëprit edhe nga anëtarët e këtij komisionit, të cilët, po ashtu, do ta japin kontributin e tyre gjatë dy ditëve të këtij kuvendi.



veprim për Asociacionin, në mënyrë që të marrë edhe një mandat dhe, pastaj, në mandatin e dytë, të veprojë dhe të shkojë drejt zbatimit të marrëveshjes për të”, thotë Demhasaj për Radion Evropa e Lirë. Artan Muhaxhiri, sociolog dhe njohës i zhvillimeve politike në Kosovë, thotë se Vetëvendosjes

dhe kryeministrit Kurti mund t'u konvenojnë zgjedhjet e parakohshme “për ta legjitimuar sërish pushtetin”. Por, sipas tij, nëse Kurti nuk ka ndonjë plan konkret për t'iu përgjigjur kërkesave të partnerëve perëndimorë lidhur me formimin e Asociacionit pas atyre zgjedhjeve, atëherë ato do të ishin të

panevojshme. “Zgjedhjet e reja kanë kuptim vetëm nëse Kosova do t'i përshpejtojë hapat drejt pranimi të Asociacionit, drejt funksionalizimit të tij, që është kërkesa kryesore edhe e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, por edhe e Bashkimit Evropian. Në të kundërtën, nuk ka ndonjë

kuptim as fitorja e Lëvizjes Vetëvendosje [në zgjedhje], edhe nëse ajo është absolute”, thotë Muhaxhiri. Kurti vazhdimisht ka insistuar se nuk mund të ketë asociacion njëetnik në Kosovë, që do të kishte kompetenca të gjera ekzekutive. Ai ka marrë shkurtimisht pushtetin në vitin 2020, ndërsa një vit më

vonë, në mars të vitit 2021, është rikthyer në krye të qeverisë. Atëkohë ai ka thënë se do të angazhohet për luftën kundër korrupsionit dhe punësimin, rritjen e prodhimit, fuqizimin e ndërmarrjeve publike e të tjera, pa përfshirë dialogun me Serbinë në mesin e prioritetëve.

Talat Xhaferi pranon mandatin për formimin e qeverisë teknike

SHKUP, 26 JANAR - Talat Xhaferi ka njoftuar të premten se ka pranuar mandatin nga presidenti i Maqedonisë së Veriut për ta formuar qeverinë. Ai ka shkruar në "Facebook" se edhe nga

pozita e kryeministrit do të vazhdojë të punojë me përkushtim. "Me krenari dhe nder të veçantë e pranova mandatin për formimin e qeverisë. Edhe nga pozita e kryeministrit do të vazhdoj të

punoj me përkushtim, me përgjegjësi dhe transparencë, duke i pasur gjithmonë parasysh mirëqenien, përparimin dhe përfitimet e qytetarëve dhe shtetit", ka shkruar Xhaferi.



Kushtetuesja në Shqipëri kundërshton bllokimin e diplomave për studentët e Mjekësisë

TIRANË, 26 JANAR - Gjykata Kushtetuese në Shqipëri pranoi pjesërisht një kërkesë të studentëve të Fakultetit të Mjekësisë, duke shfuqizuar disa nene të ligjit që i detyronte ata të punonin në Shqipëri deri në pesë vjet pas diplomimit. Sipas Gjykatës, dispozitat e kundërshtuara nga studentët sjellin kufizim të të drejtave për arsim dhe punësim, por ky kufizim ka ardhur për shkak të interesit publik për të garantuar kujdes shëndetësor.

Ky institucion e ka cilësuar joproportional afatin e vendosur nga qeveria për 'mbajtjen peng' të diplomës, me kërkesë të punës së detyrueshme për pesë vjet.


"Afati pesëvjeçar (i parashikuar nga neni 4 i ligjit) rezulton më i ashpër sesa nevoja për ta përmbushur objektivin legjitim. Duke u nisur nga premisa që afati pesëvjeçar nuk është proporcional, dhe duke marrë në konsideratë eksperiencën e vendeve të tjera, ku ky afat nuk tejkalon gjysmën e kohëzgjatjes së studimeve, u gjykua që të rishikohen edhe afatet e tjera trevjeçare dhe dyvjeçare, të

përcaktuara në të njëjtin nen", është thënë në vendimin e Gjykatës Kushtetuese.

Ligji, që synon ta ndalojë largimin e mjekëve të rinj nga Shqipëria, u miratua nga Kuvendi më 21 korrik. Sipas qeverisë, Ligji për "trajtimin e veçantë të studentëve, që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë 'Mjekësi e Përgjithshme' në institucionet publike të arsimit të lartë", ishte masa e duhur për të siguruar shërbime shëndetësore për qytetarët.

Ligji parasheh që studentët që nuk nënshkruajnë marrëveshjen për ta zbatuar këtë detyrim duhet të paguajnë një tarifë që, sipas qeverisë, është 6 500 euro në vit, por nga përlogaritja e bërë nga Bordi i Administrimit të Universitetit të Mjekësisë kjo kosto kap vlerën e 2 300 eurove. Studentët e dërguan ligjin në Gjykatë Kushtetuese në tetor të vitit 2023. Në atë kohë ligji u pezullua deri në marrjen e një vendimi përfundimtar.

Me shpalljen e këtij vendimi, Gjykata i la Kuvendit tre muaj kohë për t'i miratuar ndryshimet



e nevojshme. Gjykata ka konstatuar, gjithashtu, se në ligj mungojnë kriteret për "punësimin me prioritet, trajtimin financiar deri në gjetjen e punës, si dhe përlogaritjen e periudhës së pritjes për t'u punësuar në kohëzgjatjen e detyrimit për punësim".

Organizata "Qëndresa Qytetare", që monitoron problemet në arsim në Shqipëri, dhe ka mbështetur studentët në

protestat e tyre, ka reaguar e para pas vendimit të gjykatës.

Migen Qiraxhi, drejtues i kësaj organizate, e cilësoi vendimin fitore për studentët dhe tha se në këtë mënyrë "qeverisë i bllokohet rruga për të mbajtur peng dhe kushtëzuar edhe diplomat e mësuesve, inxhinierëve apo profesioneve të tjera".

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, kur bëri publike nismën për ta frenuar largimin e mjekëve,

pati paralajmëruar se i njëjti model do të aplikohet edhe për disa degë të tjera studimi, që vendit të mos i mungojnë profesionistët e fushave të ndryshme.

Ekspertë të mjekësisë kanë deklaruar se "eksodi" i mjekëve nuk zgjidhet me nisma të tilla, por duke rritur pagat e mjekëve dhe duke krijuar kushtet e nevojshme për ushtrimin e këtij profesioni.

Filloi ndërtimi i Qendrës Rezidenciale për të Moshuar në Podujevë



PODUJEVË, 26 JANAR - Me ceremoni solemne të premten është vendosur gurthemeli për ndërtimin e Qendrës Rezidenciale për të Moshuar në Podujevë, nga kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, kryetari i komunës, Shpejtim Bulliqi, hoxhë Halil Kastrati, kryetari i Suharekës, Bali Muharremaj, kryetari i FFK-së, Agim Ademi, komandanti i ZOLL-it, Rustem Mustafa, deputetët e Kuvendit, Vendenis Lahu dhe Floretë

Zejnullahu, drejtorë dhe asamblistë komunalë, si dhe veprimtarë e familje të dëshmorëve.

Qendra Rezidenciale do të ndërtohet në bashkëfinancim në mes të komunës së Podujevës (530 mijë) dhe Shoqatës "Jetimat e Ballkanit" (2 milionë euro).

Objekti, përveç qëndrimit ditor për të moshuar, do ta ketë edhe kuzhinën popullore për ofrimin e shujtave ditore për 200 persona, bujtinën për nxënës,

hapësira rekreative, parkun, shërbimin parësor shëndetësor, dhoma fizioterapeutike etj.

Kryetari Bulliqi u shpreh i lumtur për fillimin e ndërtimit të këtij projekti duke i uruar qytetarët llapjanë. "E gëzofshin qytetarët këtë projekt, veçanërisht të moshuarit e komunës sonë që do t'i shfrytëzojnë këto hapësira", ka thënë Bulliqi.

Fjalë rasti para medieive mbajtën edhe kryeministri Albin Kurti dhe hoxhë Halil Kastrati.

Faza e tretë e programit "Arti në shkolla" pritet të realizohet në 15 komuna

PRISHTINË, 26 JANAR - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, kanë mbajtur takim me përfaqësues nga radhët e komunave, me qëllim të diskutimit për strategjinë e bashkëpunimit për zbatimin e mëtutjeshëm të pilotprogramit "Arti në shkolla". "Faza e tretë e programit pritet të realizohet në 15 komuna dhe në të

përfshihen 10 mijë nxënës në një aktivitet kulturor në javë. Kurse deri në fund të vitit 2024, me përfundim të pilotimit, ky program do të shtrihet gradualisht në 80 % të komunave, me ç'rast rreth 50 mijë nxënës të arsimit parauniversitar do të ndërveprojnë në formë praktike me artin, të paktën një herë në javë", ka njoftuar MKRS-ja.

Në takim ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku dhe zëvendësministri i Arsimit, Taulant Kelmendi, diskutuan me përfaqësues të komunave, drejtorive komunale të arsimit dhe të kulturës, koordinatorë të programit, për ecurinë dhe sfidat në zbatimin programit "Arti në shkolla" në fazat paraprake dhe zgjerimin e tij në fazën e tretë të realizimit.



Kriza në Detin e Kuq pritet t'i rrisë disa çmime në Kosovë



PRISHTINË, 26 JANAR - Çmimet e disa produkteve në Kosovë ka rrezik të rriten sërish për shkak të krizës në Detin e Kuq. Shumë kompani detare i kanë ndaluar anijet e tyre të mallrave që të lundrojnë në këtë det dhe i kanë naviguar në drejtime të tjera më të gjata për shkak të sulmeve të rebelëve të Huthit kundër tyre. Për pasojë, kompanisë “Elkos Group” nga Kosova i duhet të paguajë deri në 6 000 euro më shumë për një kontejner prej 25 tonelatash që i vjen nga Kina. “Nga dy mijë në tetë mijë euro është rritur kostoja e transportit detar”, thotë pronari Ramiz Kelmendi për Radion Evropa e Lirë (REL). Edhe vende të tjera kanë paralajmëruar tashmë se përballen me rrezikun e rritjes së çmimeve të konsumit dhe ngadalësimit të rritjes ekonomike për shkak të kësaj krize.

Si ka nisur kriza?

Rebelët e Huthit në Jemen, të mbështetur nga Irani, kanë filluar t'i sulmojnë anijet tregtare në Detin e Kuq me raketa dhe dronë në fund të vitit të kaluar, përkatësisht pas shpërthimit të luftës midis Izraelit dhe grupit të shpallur terrorist nga ShBA-ja, Hamas. Sulmet kanë vazhduar pavarësisht prej ndërhyrjes së fuqive perëndimore kundër rebelëve të Huthit në fillim të këtij muaji. Ato e

kanë penguar transportin detar në Kanalin e Suezit, që është rruga më e shpejtë detare midis Azisë dhe Evropës dhe përmes së cilës kalon rreth 15 për qind e tregtisë detare globale. Rrjedhimisht disa nga kompanitë më të mëdha të transportit detar i kanë ridrejtuar anijet në një rrugë shumë më të gjatë përreth Afrikës. Kelmendi thotë se përpara krizës janë dashur deri në dyzet ditë kohë për pranimin e një kontejneri në portin e Selanikut në Greqi ose në atë të Durrësit në Shqipëri - “tani duhen deri në 60 ditë”. “Ne kemi marrëveshje njëvjeçare me kompanitë atje [në Kinë] dhe ato duhet të zbatohen... Nuk kemi ndërprerë asnjë dërgesë, vetëm se ka vonesa dhe e paguajmë më shtrenjtë transportin... Dërgesat përmbajnë lëndë të parë për linjat prodhuese dhe produkte finale, si teknike e bardhë dhe pajisje elektronike”, thotë Kelmendi. Kompania e tij është ndër distributoret më të mëdha të autorizuar në Kosovë të dhjetëra markave ndërkombëtare. Kelmendi thotë se rritja e kostonë së transportit tash për tash nuk vërehet te konsumatorët, sepse “po punojmë me fitim minimal”. “...por, nëse kjo situatë zgjat, mund të ketë ndryshim të çmimeve në tregun e Kosovës”, paralajmëron ai. Me vonesa në marrjen e dërgesave nga Azia në Kosovë është përballur edhe kompania transportuese e

mallrave dhe logjistikës “Pro Transport”, me qendër në Prishtinë. Pronari Faton Demaj tregon për Radion Evropa e Lirë se disa kontejnerë me produkte si lodra, tekstil dhe vegla pune, që janë porositur nga firmat kosovare qysh nga fundi i nëntorit, nuk kanë arritur ende. “Kjo, automatikisht, rrit çmimet e produkteve në treg”, thotë ai. Demaj tregon se i ka njoftuar tashmë klientët se do të ketë ngritje të konsiderueshme të çmimit të transportit, por nuk specifikon më shumë. “Çdo informatë që e marrim nga linjat detare, në formë të shkruar ua dërgojmë kompanive me të cilat bashkëpunojmë. Mundohemi t'i informojmë me kohë”, thotë ai.

Sa importon Kosova nga Kina?

Kosova varet nga importi i produkteve të huaja, si nga vendet fqinje, ato të Bashkimit Evropian dhe më larg. Të dhënat e Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) tregojnë se vitin e kaluar vendi ka importuar produkte në vlerë prej 5.8 miliardë eurosh. Vlera e eksporteve, ndërkaq, mbetet nën një miliard euro. Kosova, sipas BQK-së, rreth 10 për qind të tregtisë së jashtme e bën me Kinën. Në vitin 2022 vlera e importit nga

Kina ka qenë 548 milionë euro, ndërsa në periudhën janar-shtator të vitit 2023 ka qenë 460 milionë. Për tre muajt e fundit të vitit 2023, Radio Evropa e Lirë ka siguruar të dhëna nga Doganat e Kosovës, sipas të cilave, Kosova ka importuar nga Kina mallra në vlerë prej 189 milionë eurosh. Nëse të dhënat e dy muajve të fundit të vitit 2023 - kur edhe ka nisur kriza në Detin e Kuq - krahasohen me dy muajt e fundit të vitit 2022, del se vlera e importeve nga Kina ka qenë më e lartë. Sipas Doganave të Kosovës, në nëntor dhe dhjetor 2022 janë importuar mbi 90 milionë euro produkte, ndërsa në nëntor dhe dhjetor 2023 mbi 124 milionë. Në mesin e mallrave të importuara nga Kina ka pasur: makina të kondicionimit të ajrit, koncentrat kromi, vegla pune, pjesë plotësuese elektronike të makinave, telefona të mençur, dyshekë prej materialeve të ndryshme, artikuj prej plastike, tekstil e të tjera.

Pasojat e pashmangshme

Kosova, sikurse edhe vende të tjera në botë, është përballur me rritje të çmimeve të produkteve dhe shërbimeve vitet e fundit, pasi lufta e Rusisë me Ukrainën ka nxitur inflacionin, duke i rritur veçanërisht çmimet e naftës dhe të ushqimeve. Arian Zeka, drejtor i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë,

thotë se edhe pasojat e krizës në Detin e Kuq do të jenë të pashmangshme për Kosovën, meqë vendi importon nga Kina. Sipas tij, pritjet të ketë rritje të çmimeve të disa produkteve, por “e mira e gjithë kësaj është se mallrat ushqimore, Kosova nuk i importon në sasi të madhe nga Kina dhe shtetet aziatike”. Prej atij rajoni, India është e dyta, pas Kinës, që eksporton në Kosovë. “Shpresoj që, së paku, të mos ketë ngritje të mëtejshme të çmimeve të produkteve të konsumit të përditshëm, përfshirë këtu ushqimin dhe pijet joalkoolike”, thotë Zeka për Radion Evropa e Lirë. Pjesën më të madhe të produkteve ushqimore Kosova e importon nga vendet përreth dhe ato të BE-së. Edhe një ndër fqinjët e saj, Maqedonia e Veriut, ka paralajmëruar përmes Dhomës së saj të Tregtisë për rritjen e çmimeve të produkteve si pasojë e krizës në Detin e Kuq. Këtë javë nënkryetari i Komisionit Evropian, Valdis Dombrovskis, i cili mbikëqyr ekonominë e 27 vendeve të BE-së, tha se blloku përballat me rrezikun e rritjes së çmimeve të konsumit dhe ngadalësimit të rritjes ekonomike për shkak të ndërprerjeve të transportit detar përmes Detit të Kuq. Ai tha se trafiku i transportit detar përmes këtij deti ka rënë për 22 për qind në një muaj si pasojë e sulmeve të rebelëve të Huthit.

MFPT dhe CEB nënshkruajnë marrëveshje në vlerë 25 milionë euro për familjet e cënueshme në Kosovë

PRISHTINË, 26 JANAR - Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati dhe guvernatori i Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës (CEB), Carlo Monticelli, kanë nënshkruar marrëveshje në vlerë 25 milionë euro për krijimin e një sistemi gjithëpërfshirës të banimit social. Projekti në fjalë ka fokus të veçantë familjet e cënueshme të shoqërisë të cilat kanë të ardhura të ulëta pa zgjidhje banimi.

Përmes marrëveshjes parashihet shndërrimi i ndërtesave ekzistuese në banesa të reja sociale dhe të përballueshme, renovimi i shtëpive të cilat janë në pronësi të familjeve me të ardhura të ulëta si dhe ndërtimi i banesave të reja kolektive sociale. Në ceremoninë e nënshkrimit ministri Murati shprehu se "projekti për banimin social do ta garantojë akomodimin e dinjitetshëm dhe të

përballueshëm për familjet e cënueshme". Ndërsa guvernatori Monticelli ka deklaruar se kjo iniciativë do të ndihmojë në realizimin e objektivit të përgjithshëm të vendit për krijimin e banimit social gjithëpërfshirës për qytetarët e Kosovës. Të dyja palët u pajtuan ta thellojnë bashkëpunimin në mënyrë që qytetarët e Kosovës të kenë akomodim të përballueshëm, eficient dhe të sigurt.



Në veri të Kosovës janë regjistruar 374 biznese, rreth 280 kanë paguar tatime

MITROVICË E VERIUT, 26 JANAR - Në vitin 2023 Kosova ka mbledhur rreth dy milionë euro nga tatimet e bizneseve të regjistruara në katër komunat me shumicë serbe në veri - Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zvečan dhe Zubin Potok. Ndërkaq, rreth 93 biznese të regjistruara në këto komuna nuk i kanë shlyer detyrimet tatimore, dhe ai borxh shkon në rreth 270 mijë euro. Në një përgjigje të Administratës Tatimore të Kosovës për Radion Evropa e Lirë saktësohet se në veri të Kosovës janë gjithsej 374 biznese të regjistruara, por nga ATK-ja nuk janë përgjigjur në pyetjen se a kanë informacione se sa prej tyre janë të paregjistruara. Bazuar në hulumtimin e Institutit Kosovar për Studime të Avancuara - GAP, në marsin e vitit 2023 në Kosovë ishin rreth 97 000 biznese aktive. Nga ky

numër, 5 253 biznese ishin në pronësi të pjesëtarëve të komuniteteve pakicë, nga të cilat 30 për qind ishin në pronësi të pjesëtarëve të komunitetit serb. Më 23 janar REL-i ka shkruar për mbylljen e bizneseve në komunën e Leposaviqit për shkak të kontrollit të shtuar të bizneseve të paregjistruara në veri të Kosovës. Një nga pronarët e bizneseve të tilla, Jovica (emri i plotë i njohur për redaksinë) nga Leposaviqi, ka konfirmuar për REL-in se ka shtatë vjet që punon "në të zezë", dhe se nuk ka paguar taksa dhe detyrime të tjera. Siç tha ai, në të ardhmen do të "përpiqet" të raportojë dhe të shohë nëse do të jetë fitimprurës. Ai tha se afaristë të tjerë, të cilët deri më tani kanë punuar ilegalisht, kanë filluar t'i regjistrojnë bizneset e tyre. Policia e Kosovës, në bashkëpunim me Doganën e



Kosovës dhe ATK-në, gjatë dy muajve të fundit ka kryer disa bastisje në depo apo shitore në katër komuna në veri të Kosovës,

pasi ka marrë informacione se ato operojnë ilegalisht. Në një prononcim për Radion Evropa e Lirë, zëvendësudrejtori i

Policiisë për rajonin e veriut, Veton Elshani, u rekomandoi biznesmenëve t'i regjistrojnë bizneset e tyre.

Kosova dhe Bullgaria nënshkruajnë marrëveshje në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural



PRISHTINË, 26 JANAR - Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Faton Peci, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural me ministrin e Bujqësisë dhe Ushqimit të Bullgarisë, Kiril Vatev, i cili ishte për vizitë në Kosovë. Kjo marrëveshje është nënshkruar në takimin bilateral në mes të dy ministrave, ku me këtë rast ministri Peci ka theksuar se kjo marrëveshje ka ardhur si rezultat i marrëdhënieve miqësore dhe angazhimit për ruajtjen e partneriteteve me vendet e Bashkimit Evropian. "Përmes këtij memorandumimi synojmë ta

shtojmë bashkëpunimin në fushat me rëndësi si: ushqimi, blegtoaria, kultivimi i bimëve, kultivimi i hardhisë dhe prodhimit të verës, zhvillimi rural, peshkimi dhe akuakultura, bimët mjekësore dhe bujqësia organike", ka thënë ministri Peci, duke shtuar se me qëllim të ngritjeve të kapaciteteve humane do të realizohen edhe hulumtime, trajnime si dhe do të ndahen ekspertiza dhe përvoja në teknologjinë bujqësore. Në këtë takim të përbashkët ministri Peci dhe homologu i tij bullgar Kiril Vatev kanë diskutuar edhe për koordinimin e politikave zhvillimore në rrafshin ndërkombëtar si dy vende mike.

Më 2 shkurt do të mbahet ankandi i parë i letrave me vlerë për vitin 2024

PRISHTINË, 26 JANAR - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka njoftuar se më 2 shkurt 2024 do të mbahet ankandi i parë për vitin 2024. Në këtë ankand do të

emetohen obligacione me maturitet trevjeçar në shumën prej 20 milionë eurosh. Investimi në obligacione është investim i sigurt, i garantuar me Ligjin për Borxhin

Shtetëror dhe Garancitë Shtetërore, ku interesi i përcaktuar nga tregu ju garantohej për të gjithë kohëzgjatjen (3 vjet) dhe është tërësisht i liruar nga tatimi.

Për detaje rreth pjesëmarrjes në ankande për blerjen e letrave me vlerë, ju lutem kontaktoni ndonjërin nga bankat komerciale që operojnë në Republikën e Kosovës.




Mësimi i artit dhe herezia e njohjes

Nga: Luan RAMA

Që në lindjen e tij, njeriu ka tentuar të njohë botën me të fshehtat e saj, duke krijuar kështu një mitologji më vete me mitet e tij, nga epoka e zjarrit dhe e bronzit e deri në ditët e sotme ku mitologjitë vazhdojnë në forma moderne. Njeriu gjithnjë ka ecur me guxim drejt njohjes si ajo qenie që nis të dalë nga shpella apo tuneli i errët i një bote, duke ndjekur dritën që shfaqet tutje dhe duke shkuar me etje drejt saj, pa e ditur se çdo të ishte ajo dritë, ajo botë. Ishte një sfidë, një rendje e ethshme dhe e pafund duke rrezikuar vet ekzistencën, një tundim i jashtëzakonshëm për njohjen ...

Kur Leonardo Da Vinci nisi të kërkojë njohjen e trupit njerëzor dhe të shkojë nëpër morget e spitaleve e të bëjë hapjen e kadavrave mjerane për të studiuar anatominë njerëzore, deri te gruaja e vdekur me fëmijën në bark, padyshim që miqtë e tij e morën për të një të çmendur, por ai e ndiente se pa njohjen e trupit njerëzor nuk mund të pikturonte, nuk mund të jepte shëmbëlltyrën e figurës – edhe pse rreth tij klithën për herezi. Por, ai vazhdoi, net e ditë të tëra në atë ferr ku vetë Dante kishte zbritur me imagjinatën e tij duke përshkruar “Ferrin” e botës.

Da Vinci pikturonte kështu gjersa zërat e “herezisë” së madhe, e prekjes së trupit, e copëtimit të tij shkuan deri te Papa i Romës i cili menjëherë kërkoj ndëshkimin e artistit që ai mos të vazhdonte më në preken dhe depërtimin drejt



trupit njerëzor. E, megjithatë, gjeniu i madh kishte mundur t'i vizatonte të fshehtat njerëzore, pasi të vizatoje, të pikturoje një figurë, një grua, një fëmijë, një burrë të ri apo plak, do të duhej të njihje dinamikën e trupit dhe funksionimin e tij, të gjymtyrëve, të muskujve, çka të shërben për të dhënë një figurë sa të vërtetë aq dhe jetësore e të përsosur.

Sfida më e madhe në jetën e tij ishte pikërisht ajo çka bëri në spitalet e Firences: prerja e kufomave dhe vizatimi i tyre, i muskujve, indeve, vizatimi i tyre me rrezikun e madh që vepra e tij artistike të ndërpritej. Dhe, ajo do t'ishte ndërprerë, mrekullia që

krijohej do t'ishte ndalur, meqë vdiq edhe mbrojtësi i tij më i madh në atë kohë, Juli II. Por, fati e solli që pikërisht atëherë, në Firence të vinte mbreti francez François I, i cili kur dëgjoi për bukuritë e artistit të madh, në kthim e ftoi të shkonte të jetonte në Francë dhe të punonte atje. Dhe, më 1516, duke kapërcyer Alpet me dëborë, Leonardo shkoi për t'i shpëtuar mallkimit të kishës; shkoi i ngarkuar me disa tablo dhe me njohjen e madhe se më së fundi ai e dinte tashmë se çfarë ishte thelbi njerëzor.

Vështroj sot këto vizatime të Leonardos dhe imagjinoj piktorin e madh mes skenave

makabre që syri i njeriut s'do t'i shohë, por që ato janë të domosdoshme për imagjinatën e një artisti që do të dojë të rrokë fizionominë e botës njerëzore apo të kafshëve, dinamikën e lëvizjes së kuajve etj. Ky kërkim i ethshëm i Leonardos të kujton përsëri Danten që zbriste në rrathët e ferrit për të zbuluar natyrën njerëzore. Ishin kufij që artistët e mëdhenj duhej t'i kapërcenin. Dhe, Leonardo i kapërceu ato, kapërceu kufijtë, barrierat, atë çka i ndalohej, duke u përballur me sfidën e inkuizitorëve. Por, artisti i madh historikisht di gjithnjë të triumfojë mbi barrierat e të gjitha

ngjyrave, e të gjitha kohërave. Nën shembullin e Leonardos, të tjerë artistë vazhduan të eksplorojnë këtë botë të fshehtë të qenies njerëzore, piktorë të Renesancës italiane e gjer tek Rembrandti e këndej. Ja pse tabloja e famshme e Rembrandt “Ora e anatomisë e doktor Tulpit” (1632) ndoshta meriton lavdet postume të mjeshtrit të madh Da Vinci.

Mësimi i artit është i pandarë nga “herezia” e njohjes dhe është e pamundur që ajo të ndalet nga çdo lloj dhune e perandorie ... Një himn për njohjen, edhe kur ajo ngjason me “herezinë”!

BREZI IM, BOTA IME

Nga: Jack KEROUAC
Përktheu: Fadil BAJRAJ

Ai u ul në tren, duke shikuar nga dritarja, dhe mendoi për të rinjtë e trishtuar që ëndërrojnë ëndrra melankolike për dashurinë e pagjetur. Ai nuk ishte njëri prej tyre, sepse ai kishte gjetur dashurinë e tij; ajo ishte bash jashtë dritares së trenit.

“Brezi ynë,” mendoi ai. “Do t’ia jap zemrën dhe mendjen time brezit tonë; botës tonë. Aty është dashuria dhe jeta ime.”

Treni po kalonte pranë një projekti të strehimit të impianteve mbrojtëse në Merilend. Shtëpitë e vogla ishin të gjitha njësoj, momentalisht të shkreta, të ngjeshura së bashku dhe të zymta në muzgun që po afrohej,

“A do ta ushqejë brezi ynë këtë gjë të re, apo do ta refuzojë atë?” – mendoi ai. Një varg vagonash i gjatë me mallra kaloi në mjegullinë, duke shkuar në drejtim të kundërt. Me një shikim të shpejtë ai kapi qymyrin, rezervuarët e naftës, topat e montuar në platforma.

“Luftë,” mendoi ai. “Kombi ynë



krejt takatin e vet e ka futur në luftë.”

Trenat kaluan. Tash ai pa një depo të vogël të qytetit: turmat e ushtarëve në teshat kaki relaksoheshin të shtrirë.

“Brezi im,” pëshpëriti ai, “po bën sakrificën. Po vuan. Sall përmes vuajtjes njeriu mëson se ç’është dashuria dhe kënaqësia. Besoj se kam të drejtë kur e them këtë. Brezi im, bota ime nuk ka humbur.”


Treni vazhdoi rrugëtimin. Dielli i kuq varej mbi furrat e largëta. Furrat e larta shkarkonin avujt e tyre drithërues dhe misterioz.

“Takati,” pëshpëriti ai.

Pastaj pyjet e gjelbra i linte pas. Në

çeltninë, qëndronte një shtëpi e vogël. Një i ri u përkul për t’u përkujdesur për kopshtin e tij të fitores. Një fëmijë pranë tij. Në tren, udhëtari ngadalë bëri një nojmë.

/Telegrafi/



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Xhaka: Trajneri na transmeton urinë dhe dëshirën për të fituar, vrapon si ne në stërvitje

LEVERKUSEN, 26 JANAR - Bayer Leverkuseni është ende i pamposhtur pas 27 ndeshjeve të sezonit (24 fitore dhe 3 barazime) dhe meritë e madhe për këto rezultate ka puna e trajnerit Xabi Alonso. Mesfushori shqiptar i "Aspirinave", Granit Xhaka, ka vlerësuar në maksimum teknikun spanjoll. "Do të vijë dita

kur Xabi Alonso do ta hedhë hapin e madh, është krejtësisht normale në futboll. Por sot ne nuk e kemi ndjesinë se diçka e tillë është në mendimet e tij. E shohim çdo ditë. Ai vrapon pothuajse më shumë se ne në stërvitje. Xabi na transmeton urinë e tij dhe dëshirën për të fituar. Dhe sigurisht që edhe ne

përpiqemi të tregojmë se duam të njëjtën gjë. Për sa kohë që të jetë këtu, ne do të argëtohem. Mendoj se edhe atij i pëlqen skuadra që ka për momentin. Sigurisht që ka avantazhin e njohjes së futbollit në të gjithë aspektet. Ka fituar një mentalitet fitues si futbollist. Besojeni ose jo, ne nuk flasim fare në dhomat e

zhveshjes për titullin apo fitimin e trofeve. Forma ime? Mendoj se nuk kam bërë një punë të keqe gjatë viteve të fundit, përndryshe nuk do të isha këtu ku jam. Kam pasur një karrierë të shkëlqyer dhe ndihem shumë rehat te Leverkuseni. Gjithashtu, jam në formë shumë të mirë", ka thënë Xhaka.



Lansohet programi "Sport në shkollë", Kurti: Të ndërtohet një shoqëri e shëndetshme

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PODUJEVË, 26 JANAR - Programi "Sport në shkollë" është lansuar në komunën e Podujevës. Federata e Sportit Shkollor e Kosovës, në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe me Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, e lansuan programin që ka për qëllim shtimin e numrit të aktiviteteve sportive nëpër të gjitha shkollat fillore dhe të mesme të Kosovës si dhe përmirësimin e infrastrukturës sportive në vend. Pjesëmarrës në këtë aktivitet ishte edhe kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti. Shefi i ekzekutivit ka thënë se synohet krijimi i një shoqërie të shëndetshme. "Jemi mbledhur këtu së bashku për ta shënuar



fillimin e programit 'Sport në shkollë', nismë kjo e cila synon fuqizimin e nxënësve dhe të rinjve tanë përmes ndërlidhjes së arsimit me sportin dhe të sportit me shëndetin. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në

bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe federatat sportive, kanë hartuar programin 'Sport në shkollë' i cili ka për qëllim ndërtimin e një shoqërie aktive dhe të shëndetshme nëpërmjet pjesëmarrjes së rregullt me

aktivitete fizike dhe sportive. Mirëqenia e të rinjve është kryefjala e këtij programi", ka thënë Kurti. "Programi është hartuar në kornizë kohore prej gjashtë vitesh dhe i përfshin pesë komponentë. Zhvillimi i aktivitetit

të rregullt sportiv dhe fizik në shkollë, organizimi i garave sportive në shkollë, ngritja e kapaciteteve të mësimdhënësve për organizimin e aktivitetit sportiv, furnizimi i shkollave me pajisje sportive dhe përmirësimi i infrastrukturës sportive shkollore", ka shtuar Kurti.

Ndërsa kryetari i Podujevës, Shpëtim Bulliqi, ka thënë se ky program i ndihmon nxënësit t'i zhvillojnë aftësitë e tyre sociale. "Aspekti fizik dhe vitaliteti i nxënësve është tejet i rëndësishëm për shëndetin fizik dhe psikik të tyre. Aktivitetet sportive jo vetëm që i ndihmojnë ata që ta ruajnë një trup të shëndetshëm, por i ndihmon nxënësit t'i zhvillojnë aftësitë e tyre sociale. Angazhimi i të rinjve në sport është i rëndësishëm për të ardhmen e tyre", ka thënë Bulliqi.

Takime interesante në elitën e basketbollit

PRISHTINË, 26 JANAR - Në fundjavë zhvillohet xhiroja e 19-të e Prince Caffë Superligës së Kosovës në basketboll. Takimi i parë do të jetë në mes të Vëllaznimit dhe Golden Eagle Ylli, vendit të pestë, përkatësisht të katërt në renditje. Kuqezinjët kanë tetë fitore e dhjetë humbje, kurse therandasit kanë dhjetë fitore e tetë humbje, andaj pritët një sfidë e barabartë. Të shtunën do të përballen dy skuadrat me traditë, Sigal Prishtina dhe Bashkimi. Bardhekaltrit janë në

vendin e tretë me 12 fitore e gjashtë humbje, kurse portokallezinjtë në vendin e gjashtë me shtatë fitore dhe 11 humbje. Të dielën do të përballen Proton Cable Prizreni me Trepçën. Prizrenasit janë në vendin e shtatë me pesë fitore e 13 humbje, kurse mitrovicasit janë liderë me 16 fitore e dy humbje, prej tyre 11 fitore radhazi. Dueli i fundit është në mes të Pejës dhe Istogut. Kampionët e Kosovës shihen favoritë, pasi janë në vendin e



SUPERLIGA - Java 19

Të shtunën takohen:
17:00 Vëllaznimi - Golden Eagle Ylli
19:00 Sigal Prishtina - Bashkimi

Të dielën takohen:
17:00 Proton Cable Prizreni - Trepça
19:00 Peja - Istogu

dytë me 13 fitore dhe pesë humbje, ndërsa skuadra istogase ka vetëm një fitore e 17 humbje.


Tare: Inzaghi ndër më të mirët në botë, Interi favorit për titull

TIRANË, 26 JANAR - Igli Tare e konsideron trajnerin e Interi Simone Inzaghin si njëri nga më të mirët në botë, derisa skuadrën e tij e sheh si favorite për ta tituar titullin e kampionit në Itali, edhe pse, sipas tij, kjo nuk do të jetë e lehtë. "Interi mbetet skuadra që duhet mposhtur sepse bëri transferime të rëndësishme dhe është i fortë, por gjithçka do të

vendoset në mars. 'Nerazzurrit' tani do të kenë kundërshtarë të ashpër si Fiorentina, Juve, Roma dhe Atalanta, plus Atletico në Ligën e Kampionëve", ka theksuar ai. Ai ka theksuar se Interi ka shumë cilësi, por duhet pasur parasysh që nga tani e tutje ka shumë ndeshje për t'u zhvilluar. "Për sa i përket alternativave cilësore, Interi nuk ka kundërshtar,

por ky avantazh, të paktën në Serinë A, përfundon nëse luan çdo tre ditë dhe pastaj janë çerekfinalet e Ligës së Kampionëve", ka shtuar ai. Madje, ish-drejtori i Lazios ka thënë se Interin e sheh ndër skuadrat favorite edhe në Ligën e Kampionëve. "E shoh Interin në mesin e favoritëve, së bashku me Bayernin dhe Cityn. Simone është një nga teknikët më të mirë në

botë dhe di të menaxhojë angazhimin e dyfishtë javor. Konfirmimi u dha në Superkupë: kishin ekipin më të fortë dhe sollën në shtëpi trofeun. Tani atij i mungon Scudetto për të kurozëzuar karrierën e tij, por ai tashmë kishte fituar kupa me Lazion dhe ishte kualifikuar në Ligën e Kampionëve", ka shtuar Tare.



Shqipëria në mars zhvillon miqësore me Suedinë

Tiranë, 26 janar - Kombëtarja e Shqipërisë shqiptare do të luajë një ndeshje miqësore me Kombëtaren e Suedisë në datat e lira të FIFA-s në muajin mars. “Top Channel” raporton se Federata Shqiptare e Futbollit ka

arritur marrëveshje me Federatën Suedeze që ky takim të luhet më 25 mars 2024. Takimi mes kuqezinjve dhe suedezëve do të zhvillohet në stadiumin “Friends Arena” në Stokholm të Suedisë, ndërsa

orari thuhet se mbetet për t’u përcaktuar. Sa i përket miqësore me Suedinë, kjo do të jetë hera e gjashtë që dy ekipet kombëtare do të përballen në një ndeshje futbollit. Në të kaluarën Shqipëria dhe Suedia

janë përballur vetëm një herë në një ndeshje miqësore që është fituar nga kuqezinjtë me rezultatin 2-1. Ndryshe, Suedia ka dështuar të kualifikohet për “Euro 2024”, pasi përfundoi e treta në Grupin F, ku



Kloppi konfirmon largimin nga LiverpooLi

LIVERPOOL, 26 JANAR - Trajneri Jurgen Klopp ka konfirmuar largimin nga LiverpooLi në fund të sezonit 2024/25. Kloppi ka fituar çdo trofe të mundshëm me klubin nga “Anfield” në tetë vitet e tij trajner. Megjithatë, çdo “të mire” i vjen një fund dhe fundi i Kloppit si trajner i LiverpooLit është afruar tashmë. Është vetë trajneri gjerman i cili ka konfirmuar largimin nga “Reds” në një intervistë për faqen zyrtare të LiverpooLit. “Unë do të largohem nga klubi në fund të sezonit. Mund ta kuptoj se është një tronditje për shumë njerëz në këtë moment, kur e dëgjon për herë të parë, por padyshim që mund ta shpjegoj – ose të paktën të përpiqem ta shpjegoj”, ka thënë Kloppi. “Më pëlqen absolutisht gjithçka për këtë klub, më pëlqen gjithçka për qytetin, më pëlqen gjithçka për tifozët tanë, e dua ekipin, e dua



stafin. Unë dua gjithçka. Por që unë e marr këtë vendim tregon se jam i bindur se është ai që duhet të marr. Ndihej, si ta them, se po më mbaron energjia. Nuk kam asnjë problem tani. E dija që më gjatë se do të më duhet ta shpallja në një moment, por tani jam absolutisht mirë. E di që nuk mund ta bëj punën

përsëri dhe përsëri dhe përsëri dhe përsëri”, ka shtuar Kloppi. “Pas viteve që patëm bashkë dhe pas gjithë kohës që kaluam bashkë dhe pas të gjitha gjërave që kaluam së bashku, respekti u rrit për ty, dashuria u rrit për ty dhe më e pakta që të detyrohem është e vërteta – dhe kjo është e vërteta”, ka përfunduar gjermani.

Fitojnë Bostoni, Indiana e lakersat, humbasin Denveri dhe Golden State



MIAMI, 26 JANAR - Bostoni është gjithnjë lider në Konferencën e Lindjes, duke fituar me rezultat 143-110 në fushën e Miamit. Një ndeshje e komanduar nga miqtë, ku u dallua Tatum me 26 pikë, ndërkohë që 7 lojtarë të Celticsit realizuan mbi 10 pikë. Fitoi edhe ekipi i lakersave, që

mundi me rezultat 141-132 Chicagon, në një ndeshje spektakolare. Katër lojtarë të lakersat realizuan mbi 20 pikë (Russelli me 29 më i miri), duke i bërë të pavlefshme 32 pikët e DeRozanit për Bulls. Sacramento mposhti në sekondat e fundit me rezultat

134-133 Golden Staten, ku për miqtë u dallua Barnesi, autor i 39 pikëve. 33 pikët e Curryt mbetën për statistikë. Fitoi edhe Indiana, që falë 26 pikëve të Siakamit, mundi me rezultat 134-122 Philadelphian. Minnesota rimerr kreun në Perëndim, duke mundur me rezultat 96-94 Brooklynin, sfidë ku u dallua Townsi me 27 pikë. Bie skuadra kampione e Denverit, që u mund thellë me rezultat 122-84 nga New Yorku. Për vendasit u dallua Anunoby me 26 pikë.

REZULTATET

Indiana - Philadelphia	134-122
Washington - Utah Jazz	108-123
Brooklyn - Minnesota	94-96
Miami - Boston	110-143
New York - Denver	122-84
Golden State - Sacramento	133-134
Lakers - Chicago	141-132

SHKURT

Prishtina mposhtet në miqësore nga NK Celje

Skuadra e madhe FC Prishtina ka pësuar humbje në ndeshjen e fundit kontrolluese në Antalia nga kampionët e Sllovenisë dhe aktualisht lidere në kampionatin elitër, NK Celje. Golat e fitores për skuadrën sllovene i shënuan Zec (19') dhe Bajdet (43'). Kryeqytetasit rikthehen në Kosovë dhe vazhdojnë përgatitjet për përballjen në kupë me Gjilanin, e cila zhvillohet më 3 shkurt.

Gjokoviqi turpërohet në gjysmëfinale të Australia Openit

Tenisti serb Novak Gjokoviqi është eliminuar nga gjysmëfinalja e Australia Openit, pasi është mposhtur nga tenisti italian Jannik Sinner. Sinner e mposhti Gjokoviqin me rezultat 3-1 me sete, 6-1, 6-2, 6-7 dhe 6-3, ku arriti për herë të parë në finalen e Grand Slamit. Italiani në finale do të përballlet me fituesin e ndeshjes Daniil Medvedev-Alexander Zverev, që do të luhet këtë të diel. Po ashtu, Sinner e ka thyer edhe një rekord duke u bërë finalist i më i ri i një Grand Slami prej vitit 2008, të cilin e mbante vetë Gjokoviqi.

Lavezzi izolohet në një spital psikiatrik

Ezequiel Lavezzi është duke kaluar ndoshta periudhën më të errët në jetën e tij. Argentinasi është shtruar tashmë në një spital psikiatrik në Buenos Aires për shkak se vuan nga ipomania, një sëmundje që prek humorin e një personi duke e bërë atë edhe të jetë agresiv. Sipas medieve, ish-sulmuesi i Napolit i është nënshtruar një trajtimi shumë të rreptë, madje ka kaluar edhe disa ditë në izolim total. Ndërkohë, “L'Equipe” zbulon edhe bisedën në mes të Lavezzit dhe një të afërmi të tij. Ky i fundit tregon se argentinasi i ka thënë se të gjithë këtë sakrificë po e bën për djalin e tij, pasi i duhet të shërohet dhe t'i rikthehet jetës normale duke lënë pas abuzimet me drogën dhe alkoolin.

Phillipsi huazohet në West Ham

Kalvin Phillips është lojtar i ri i West Ham Unitedit. Mesfushori anglez largohet nga Manchester City dhe kalon në West Ham në formë huazimi. “West Ham Unitedi është i kënaqur ta konfirmojë afrimin e mesfushorit anglez Calvin Phillips në huazim deri në fund të sezonit 2023/24. 28-vjeçari vjen nga Manchester City dhe mund ta bëjë debutimin e tij në ndeshjen e së enjtes në Premierë Ligë me AFC Bournemouth”, thuhet në njoftimin e West Hamit. Phillipsi asnjëherë nuk arriti të gjejë hapësira në formacionin e Pep Guardiols, prandaj edhe vendosi të largohet nga City.

Hamiltoni për Verstappenin dhe Alonson: Të tre jemi jashtëzakonisht konkurrues

Gjatë një interviste të dhënë për mediet holandeze, piloti britanik Lewis Hamilton, 7 herë kampion bote në Formula 1, foli për marrëdhënien me rivalin e


tij Max Verstappen. Britaniku i ul kapelën pilotit të Red Bullit, duke vlerësuar sezonin e tij të fundit. “Max duhet të vazhdojë të bëjë atë që po bën. Ai po bën

një punë të shkëlqyer ashtu sikurse edhe Alonso. Unë mendoj se Max dhe Fernando kanë një gjë të përbashkët me mua: Të tre jemi

jashtëzakonisht konkurrues”, u shpreh Hamiltoni. Më tej, britaniku vazhdoi: “Ne jemi të gatshëm të bëjmë gjithçka për të marrë atë që duam. Nuk mund

të them shumë gjëra të tjera për ta si njerëz, i njoh vetëm përmes garave të Formulës 1. Ne nuk e shohim njëri-tjetrin shpesh jashtë pistave”.

10 vite pa më të dashurin tonë



Mustafë Isufi

10 vite sa 10 shekuj. Na mungon në çdo pjesë të jetës babi.

Ke qenë dhe do të mbetesh shembulli më i mire i një babe.

Te përkujton me mall bashkëshortja Xhemilja me fëmijët : Lavdia, Gazmendi, Arbeni, Merita dhe Mentori .

MEKA
®
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

